



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 26

Tiranë – E premte, 19 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave nr. 1, datë 5.2.2016	Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore..... 2307
Urdhër i Bordit të Partnerëve për Zhvillim i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal 1 nr. 1, datë 11.1.2016	Për emërim në detyrë..... 2319
Urdhër i Bordit të Partnerëve për Zhvillim i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal 3 nr. 1, datë 11.1.2016	Për emërim në detyrë..... 2319

UDHËZIM

Nr. 1, datë 5.2.2016

**PËR VENDOSJEN E NIVELEVE
MAKSIMALE PËR DISA KONTAMINUES
NË PRODUKTET USHQIMORE¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 41, pika 12, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Produktet ushqimore, të listuara në shtojcën bashkëlidhur këtij udhëzimi (më poshtë shtojcë), nuk vendosen në treg kur përmbajnë një kontaminues të listuar në shtojcë në një nivel që ka tejkaluar nivelin maksimal të vendosur.

2. Nivelet maksimale, të specifikuar në shtojcë, të zbatohen për pjesën e ngrënshme të produkteve ushqimore, nëse nuk specifikohet ndryshe në shtojcë.

3. Produktet ushqimore të thara, të holluara, të përpunuara dhe të përbëra:

a) Kur zbatohen nivelet maksimale të vendosura në shtojcë për produktet ushqimore që janë të thara, të holluara, të përpunuara ose të përbërë me më shumë se një përbërës, të merren në konsideratë sa më poshtë:

i) ndryshimet në përqendrimin e kontaminuesit të shkaktuar nga procesi i tharjes ose i hollimit;

ii) ndryshimet në përqendrimin e kontaminuesit të shkaktuar nga përpunimi;

iii) raportet përkatëse të përbërësve në produkt;

iv) kufiri analitik i përcaktimit të sasisë.

b) Faktorët specifikë të përqendrimit ose hollimit për proceset e tharjes, hollimit, përpunimit dhe/ose përzierjes për artikujt ushqimorë të tharë, të holluar, të përpunuar dhe/ose të përbërë, duhet të sigurohen dhe të justifikohen nga operatori i biznesit ushqimor, kur kryhet një kontroll zyrtar.

Nëse operatori i biznesit ushqimor nuk jep faktorin e domosdoshëm të përqendrimit apo hollimit ose nëse inspektori i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit gjykon se ky faktor është i

papërshtatshëm në funksion të justifikimit të dhënë, atëherë vetë Autoriteti Kombëtar i Ushqimit përcakton këtë faktor, bazuar në informacionin në dispozicion dhe të objektivit të mbrojtjes maksimale të shëndetit të njeriut.

4. Ndalimet në përdorim, përzierje dhe detoksifikim:

a) Produktet ushqimore, që nuk përputhen me nivelet maksimale të vendosura në shtojcë, nuk duhet të përdoren si përbërës ushqimorë;

b) Produktet ushqimore, që përputhen me nivelet maksimale të vendosura në shtojcë, nuk duhet të përzihen me produktet ushqimore, të cilat tejkalojnë këto nivele maksimale;

c) Produktet ushqimore, që janë për ndarje ose trajtime të tjera fizike për të reduktuar nivelet e kontaminimit, nuk duhet të përzihen me produkte ushqimore, që janë të destinuara për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor apo me produkte ushqimore të paracaktuara të jenë për përdorim si përbërës ushqimorë;

d) Produktet ushqimore, që përmbajnë kontaminues të listuar në pjesën 2 të shtojcës (*Mykotoksinat*), nuk duhet të detoksifikohen me anë të trajtimeve kimike.

5. Masa specifike për kikirikët, farat vajore të tjera, pemët arrore, frutat e thata, oriz dhe misër:

Kikirikët, fara vajore të tjera, arrorët, frutat e thata, orizi dhe misri, që nuk përputhen me nivelet maksimale të përshtatshme të aflatoksinave të përcaktuara në pikat 2.1.3, 2.1.5 dhe 2.1.6 të shtojcës, mund të vendosen në treg kur sigurohet që: nuk janë të destinuara për konsum direkt njerëzor ose të përdoren si përbërës në produktet ushqimore;

a) Përputhen me nivelet maksimale të dhëna në pikat 2.1.1, 2.1.2, 2.1.3., 2.1.4, 2.1.9 dhe 2.1.12 të shtojcës;

b) Janë objekt trajtimi, duke përfshirë ndarjen ose trajtime të tjera fizike dhe, pas këtij trajtimi, nivelet maksimale të përcaktuara në pikat 2.1.5, 2.1.6, 2.1.7, 2.1.8, 2.1.10 dhe 2.1.11 të shtojcës nuk janë tejkaluar dhe ky trajtim nuk rezulton në mbetje të tjera të dëmshme;

c) Etiketohen qartësisht duke treguar përdorimin e tyre dhe mbartin treguesin “produkti duhet të jetë objekt për ndarjen apo për trajtime të tjera fizike për të reduktuar kontaminimin me aflatoksinë përpara konsumit për njerëz ose përdorimit si përbërës në produktet ushqimore”.

¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me:

Rregullore e Komisionit (EC) nr. 1881/2006 të 19 dhjetorit 2006 për përcaktimin e niveleve maksimale për kontaminues të caktuara në produktet ushqimore, i ndryshuar; numri CELEX 2006R1881; Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 364, datë 20.12.2006, faqe 5.



Treguesi duhet të përfshihet në etiketën e çdo ambalazhi individual ose në dokumentin origjinal shoqërues. Kodi i identifikimit të ngarkesës/paketës duhet të jetë që nuk fshihet në çdo ambalazh individual të ngarkesës dhe në dokumentin origjinal shoqërues.

6. Masa specifike për kikirikët, farat vajore të tjera, produkte të tyre të derivuara dhe drithërat:

Një tregues i qartë për përdorimin e caktuar duhet të vendoset në etiketën e çdo ambalazhi individual ose në dokumentin origjinal shoqërues. Dokumenti origjinal shoqërues duhet të ketë lidhje të qartë me ngarkesën me anë të vendosjes në të, të kodit të identifikimit të ngarkesës, i cili ndodhet në çdo ambalazh individual të ngarkesës.

Në mungesë të një përcaktimi të qartë, që përdorimi i tyre i paracaktuar nuk është për konsum njerëzor, nivelet maksimale të dhëna në pikat 2.1.5. dhe 2.1.11 të shtojcës duhet të zbatohen te të gjithë kikirikët, farat vajore të tjera, produktet e tyre të derivuara dhe drithërat e vendosura në treg.

Në lidhje me përjashtimin e kikirikëve dhe farave të tjera vajore për shtrydhje (prodhim vaji) dhe aplikimit të niveleve maksimale të përcaktuara në pikën 2.1.1 të shtojcës, përjashtimi zbatohet vetëm për ngarkesat të cilat janë të etiketuara qartë

duke treguar përdorimin e tyre dhe duke pasur treguesin “Produkti është objekt i shtrydhjes për prodhimin e vajit bimor të rafinuar”. Treguesi duhet të përfshihet në etiketën individuale të çdo ambalazhi dhe në dokumentin shoqërues. Destinacioni përfundimtar duhet të jetë një fabrikë prodhimi vaji.

7. Masa specifike për marulen:

Përveç marules së rritur nën mbulesë (marulja e mbrojtur) të etiketuar si të tillë, nivelet maksimale të vendosura në shtojcë duhet të zbatohen për marulen e rritur në ambient të hapur (marulja e rritur e pambuluar).

8. Udhëzimi nr. 13, datë 29.9.2010, “Për vendosjen e niveleve maksimale për disa kontaminues në produktet ushqimore”, shfuqizohet.

9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Bujqësore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Edmond Panariti

SHTOJCË NIVELET MAKSIMALE PËR KONTAMINUES TË CAKTUAR NË PRODUKTET USHQIMORE ⁽¹⁾

Pjesa 1: Nitratet

Nr.	Produkti	Niveli maksimal (mg NO ₃ /kg)
1.1	Spinaq i freskët (<i>Spinacia oleracea</i>) ⁽²⁾	3 000
1.2	Spinaq i konservuar, i ngrirë thellë ose i ngrirë	2 000
1.3	Marule e freskët (<i>Lactuca sativa</i> L.) (marule e mbrojtur dhe e rritur në ambient të hapur) duke përjashtuar marulen e listuar në pikën 1.4	Vjelë nga 1 tetori deri 31 mars; Marule e rritur e mbuluar (e mbrojtur) 5 000 Marule e rritur në ambient të hapur 4 000 Vjelë nga 1 prilli deri 30 shtator; Marule e rritur e mbuluar (e mbrojtur) 4 000 Marule e rritur në ambient të hapur 3 000
1.4	Marule e tipit ajsberg	Marule e rritur e mbuluar (e mbrojtur) 2 500 Marule e rritur në ambient të hapur 2 000
1.5	Rukola (<i>Eruca sativa</i> , <i>Diplotaxis</i> sp., <i>Brassica tenuifolia</i> , <i>Sisymbrium tenuifolium</i>)	Vjelë nga 1 tetori deri 31 mars 7 000 Vjelë nga 1 prilli deri 30 shtator 6 000
1.6	Ushqimet me bazë drithi të përpunuara dhe ushqimet për foshnje dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽⁴⁾	200



Pjesa 2: Mykotoksinat

Nr.	Produkti	Niveli maksimal (µg/kg)		
		B ₁	B ₁ + B ₂ + G ₁ + G ₂	M ₁
2.1	Aflatoksina			
2.1.1	Kikirikët dhe farërat e tjera vajore ⁽⁴⁰⁾ , që i janë nënshtruar ndarjes ose trajtimeve të tjera fizike para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës ushqimorë, me përjashtim të: - kikirikëve dhe farërave të tjera vajore për shtrydhje për prodhimin e vajit bimor të rafinuar	8,0 ⁽⁵⁾	15,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.2	Bajame, fistikë dhe kajsi, që janë objekt i ndarjes ose trajtimeve të tjera fizike para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës ushqimorë	12,0 ⁽⁵⁾	15,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.3	Lajthi dhe arra Brazili që janë objekt i ndarjes, ose trajtimeve të tjera fizike para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës ushqimorë	8,0 ⁽⁵⁾	15,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.4	Pemët arnore, të tjera nga ato të listuara në 2.1.2 dhe 2.1.3 që i janë nënshtruar ndarjes ose trajtimeve të tjera fizike, para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës në ushqime	5,0 ⁽⁵⁾	10,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.5	Kikirikët dhe farat e tjera vajore ⁽⁴⁰⁾ dhe produktet e tyre të përpunuara, të përcaktuara për konsum direkt njerëzor ose si një ingredient ushqimor, me përjashtim të: - vajrat bimorë të papërpunuara të destinuara për rafinim; - vajrat bimorë të rafinuara.	2,0 ⁽⁵⁾	4,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.6	Bajame, fistikë dhe kajsi të përcaktuara për konsum direkt njerëzor ose si një ingredient ushqimor ⁽⁴¹⁾	8,0 ⁽⁵⁾	10,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.7	Lajthi dhe arra Brazili, të destinuara për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor ose përdorim si një ingredient ushqimor ⁽⁴¹⁾	5,0 ⁽⁵⁾	10,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.8	Pemët arnore, të listuara në 2.1.6 dhe 2.1.7, dhe produkteve të përpunuara të tyre, të destinuara për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor ose përdorim si një ingredient ushqimor	2,0 ⁽⁵⁾	4,0 ⁽⁵⁾	-
2.1.9	Fruta të thata, të tjera nga fiku, që janë objekt i ndarjes ose trajtimeve të tjera fizike para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës ushqimorë	5,0	10,0	-
2.1.10	Fruta të thata dhe të përpunuara të përcaktuara për konsum direkt njerëzor ose si një ingredient ushqimor	2,0	4,0	-
2.1.11	Të gjitha drithërat dhe produktet që rrjedhin nga drithërat, duke përfshirë produktet e përpunuara të drithërave, me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.1.12, 2.1.15 dhe 2.1.17	2,0	4,0	-
2.1.12	Misri dhe orizi, që janë objekt i ndarjes ose trajtimeve të tjera fizike para përdorimit për konsum njerëzor ose përdorimit si përbërës ushqimorë	5,0	10,0	-
2.1.13	Qumështi i freskët ⁽⁶⁾ , qumështi për prodhimin e nënprodukteve të tij, qumësht i trajtuar në të nxehtë	-	-	0.050
2.1.14	Speciet e mëposhtme të erëzave: <i>Capsicum</i> spp. (fruta të thata, të plota ose të bluara, spec djegës, spec djegës i bluar, spec i kuq dhe spec) <i>Piper</i> spp. (fruta, duke përfshirë piperin e bardhë dhe të zi) <i>Myristica fragrans</i> (arrëmyshku) <i>Zingiber officinale</i> (xhenxhefil) <i>Curcuma longa</i> (shafran i Indisë)	5,0	10,0	-



	Përzierje e erëzave që përmbajnë një ose më shumë nga erëzat e lartpërmendura.			
2.1.15	Ushqimet e përpunuara me bazë drithi dhe ushqime për foshnjat dhe fëmijë të vegjël ^{(3) (7)}	0.10	-	-
2.1.16	Formula për foshnje dhe <i>follow-on</i> formula, duke përfshirë qumështin për foshnje dhe qumështin <i>follow-on</i> ^{(4) (8)}	-	-	0.025
2.1.17	Ushqimet dietetike për qëllime të caktuara mjekësore ⁽⁹⁾ ⁽¹⁰⁾ të përcaktuara veçanërisht për foshnjat.	0.10	-	0.025
2.1.18	Fig të thatë	6.0	10.0	-
2.2	Ochratoxin A			
2.2.1	Drithëra të papërpunuara		5.0	
2.2.2	Të gjitha produktet e derivuara nga drithëra të papërpunuara, duke përfshirë produktet e përpunuara të drithit dhe drithërat e përcaktuara për konsum direkt për njerëz me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.2.9., 2.2.10 dhe 2.2.13.		3.0	
2.2.3	Fruta të thata hardhi (stafidhe, rrush të thatë dhe sultanas)		10.0	
2.2.4	Kafe kokërr e pjekur, kafe e pjekur e bluar, me përjashtim të kafes së tretur		5.0	
2.2.5	Kafe e tretur (në vend të kafes)		10.0	
2.2.6	Verë (duke përfshirë verë të gazuar, me përjashtim të likerit dhe verës me gradë alkoolike e jo më pak se 15 % vol) dhe verë frutash ⁽¹¹⁾		2.0 ⁽¹²⁾	
2.2.7	Verë e aromatizuar, pije me bazë vere të aromatizuar dhe kokteje vere të aromatizuar ⁽¹³⁾		2.0 ⁽¹²⁾	
2.2.8	Lëngu i rrushit, lëngu i rrushit i koncentruar i riformuar, nektar rrushi, mushti i rrushit dhe mushti i rrushit të koncentruar i riformuar, i përcaktuar për konsum direkt njerëzor ⁽¹⁴⁾		2.0 ⁽¹²⁾	
2.2.9	Ushqimet e përpunuara me bazë drithi dhe ushqime për foshnjat dhe fëmijë të vegjël ^{(3) (7)}		0.50	
2.2.10	Ushqimet dietetike për qëllime të caktuara mjekësore ⁽⁹⁾ ⁽¹⁰⁾ të përcaktuara veçanërisht për foshnjat.		0.50	
2.2.11	Erëzat, përfshirë erëzat e thata <i>Piper</i> spp. (fruta, duke përfshirë piperin e bardhë dhe të zi) <i>Myristica fragrans</i> (arrëmyshku) <i>Zingiber officinale</i> (xhenxhefil) <i>Curcuma longa</i> (shafran i Indisë) <i>Capsicum</i> spp. (fruta të thata, të plota ose të bluara, spec djegës, spec djegës i bluar, spec i kuq dhe spec) Përzierje e erëzave që përmbajnë një ose më shumë nga erëzat e lartpërmendura.		15 µg/kg 15 µg/kg 15 µg/kg	
2.2.12	Liquorice (<i>Glycyrrhiza glabra</i> , <i>Glycyrrhiza inflata</i> dhe specie të tjera)			
2.2.12.1	Rrënjë liquorice, ingredient për ekstraktimin e erëzave		20 µg/kg	
2.2.12.2	Ekstrakt liquorice ⁽⁴²⁾ , për përdorim në ushqime, veçanërisht pije dhe ëmbëlsira		80 µg/kg	
2.2.13	Gluten gruri që nuk shitet direkt te konsumatori		8.0	
2.3	Patulin			
2.3.1	Lëngje frutash, lëngje frutash të përqendruara të riformuara dhe nektar frutash ⁽¹⁴⁾		50	
2.3.2	Pije ⁽¹⁵⁾ , musht dhe pije të tjera të fermentuara që rrjedhin nga mollë ose përmbajnë lëng molle		50	
2.3.3	Produkte molle të ngurta, duke përfshirë komposto me mollë, pure molle të destinuara për konsum të		25	



	drejtpërdrejtë me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.3.4 dhe 2.3.5	
2.3.4	Lëng molle dhe produkte të ngurta molle, duke përfshirë edhe komposto molle dhe pure molle, për foshnjat dhe fëmijë të vegjël ⁽¹⁶⁾ dhe etiketohen dhe shiten si të tillë ⁽⁴⁾	10.0
2.3.5	Ushqime për bebe të tjera nga ushqimet e përpunuara me bazë drithi për foshnje dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽⁴⁾	10.0
2.4	Deoxynivalenol ⁽¹⁷⁾	
2.4.1	Drithëra të papërpunuara ⁽¹⁸⁾ ⁽¹⁹⁾ përveç grurit durum, tërshërës dhe misrit	1250
2.4.2	Tërshërat dhe gruri durum i papërpunuar ⁽¹⁸⁾ ⁽¹⁹⁾	1750
2.4.3	Misri i papërpunuar ⁽¹⁸⁾ , me përjashtim të misrit të papërpunuar i paracaktuar të përpunohet me bluarje të lagësht ⁽³⁷⁾	1750 ⁽²⁰⁾
2.4.4	Drithëra të destinuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, miell drithërash, krunde dhe embrion si produkt i fundit që tregtohet për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.4.7, 2.4.8 dhe 2.4.9	750
2.4.5	Makarona (të thara) ⁽²²⁾	750
2.4.6	Bukë (duke përfshirë produkte të vogla furre), pasta, biskota, snacks drithëra dhe drithëra për mëngjes	500
2.4.7	Ushqime të përpunuara me bazë drithi dhe ushqime për foshnjat dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽⁷⁾	200
2.4.8	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash > 500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1103 13 ose 1103 20 40 dhe produkte të tjera misri të bluar me madhësi së grimcave > 500 mikronë që nuk përdoret për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	750 ⁽²⁰⁾
2.4.9	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash ≤ 500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1102 20 dhe produkte të tjera misri të bluar me madhësi të grimcave ≤ 500 mikronë që nuk përdoret për konsum të drejtpërdrejtë të njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	1250 ⁽²⁰⁾
2.5	Zearalenone ⁽¹⁷⁾	
2.5.1	Drithëra të papërpunuara ⁽¹⁸⁾ ⁽¹⁹⁾ të tjera nga misri	100
2.5.2	Misri i papërpunuar ⁽¹⁸⁾ , me përjashtim të misrit të papërpunuar i paracaktuar të përpunohet me bluarje të lagësht ⁽³⁷⁾	350 ⁽²⁰⁾
2.5.3	Drithëra të destinuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, miell drithërash, krunde dhe embrion si produkt i fundit që tregtohet për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.5.6, 2.5.7, 2.5.9 dhe 2.5.10.	75
2.5.4	Vaj misri i rafinuar	400 ⁽²⁰⁾
2.5.5	Bukë (duke përfshirë produkte të vogla furre), pasta, biskota, snacks drithëra dhe drithëra për mëngjes me përjashtim të snack me bazë misri dhe drithërave për mëngjes me bazë misri	100 ⁽²⁰⁾
2.5.7	Ushqime të përpunuara me bazë drithi (duke përjashtuar ushqimet e përpunuara me bazë misri) dhe ushqime për foshnjat dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽⁷⁾	20
2.5.8	Ushqime të përpunuara me bazë misri për foshnja dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽⁷⁾	20 ⁽²⁰⁾
2.5.9	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash >	



	500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1103 13 ose 1103 20 40 dhe produkte të tjera misri të bluar me madhësi të grimcave > 500 mikronë që nuk përdoret për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	200 ⁽²⁰⁾
2.5.10	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash ≤ 500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1102 20 dhe produkte të tjera misri të bluar me madhësi të grimcave ≤ 500 mikronë që nuk përdoret për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	300 ⁽²⁰⁾
2.6	Fumonisin	Shuma e B ₁ dhe B ₂
2.6.1	Misri i papërpunuar ⁽¹⁸⁾ , me përjashtim të misrit të papërpunuar i paracaktuar të përpunohet me bluarje të lagësht ⁽³⁷⁾	4000 ⁽²³⁾
2.6.2	Misër i destinuar për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, ushqimeve me bazë misri për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor, me përjashtim të produkteve ushqimore të listuara në 2.6.3 dhe 2.6.4	1000 ⁽²³⁾
2.6.3	Drithëra me bazë misri për mëngjes dhe snack me bazë misri	800 ⁽²³⁾
2.6.4	Ushqime të përpunuara me bazë misri për foshnja dhe fëmijë të vegjël ^{(3) (7)}	200 ⁽²³⁾
2.6.5	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash > 500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1103 13 ose 1103 20 40 dhe produkte të tjera misri të bluara me madhësi të grimcave > 500 mikronë që nuk përdoren për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	1400 ⁽²³⁾
2.6.6	Fraksionet e misrit të bluar me madhësi grimcash ≤ 500 mikronë që trajtohen në kodin CN 1102 20 dhe produkte të tjera misri të bluar me madhësi të grimcave ≤ 500 mikronë që nuk përdoren për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor që trajtohen me kodin CN 1904 10 10	2000 ⁽²³⁾
2.7	T-2 and HT-2 toxin ⁽¹⁷⁾	Shuma e toksinave T-2 dhe HT-2
2.7.1	Drithëra të papërpunuara ⁽¹⁸⁾ dhe produkte drithi	

Pjesa 3: Metalet

Produkte ushqimore		Nivelet max. (mg/kg peshe e lagët)
3.1	Plumbi	
3.1.1	Qumësht i papërpunuar ⁽⁶⁾ , qumësht me trajtim në të nxehtë dhe qumësht për prodhimin e produkteve me bazë qumështi	0.020
3.1.2	Formula për fëmijë dhe <i>follow up</i> formula ^{(4) (8)}	0.020
3.1.3	Mishi (me përjashtim të të përbrendshmeve) i kafshëve të gjedhit, deleve, derrave dhe shpendëve ⁽⁶⁾	0.10
3.1.4	Të përbrendshmet e gjedhit, deleve, derrave dhe shpendëve ⁽⁶⁾	0.50
3.1.5	Muskuli i peshkut ^{(24) (25)}	0,30
3.1.6	Krustaceve ⁽²⁶⁾ : mishi i muskujve që ka divergjuar nga trangu aksial dhe stomaku ⁽⁴⁴⁾ . Në rastin e gaforreve dhe gaforreve të ngjashme me krustacet (<i>Brachyura</i> dhe <i>Anomura</i>) mishi i muskujve që ka divergjuar nga trangu aksial	0.50
3.1.7	Molusqet bivalve ⁽²⁶⁾	1,5
3.1.8	<i>Cephalopode</i> (pa organet e brendshme) ⁽²⁶⁾	1.0
3.1.9	Drithëra, fasule dhe perime bishtajore ⁽²⁷⁾	0.20
3.1.10	Perimet, me përjashtim të perimeve të familjes <i>brassica</i> , perimeve me fletë, erëzave të	



	freskëta dhe kërpudhave ⁽²⁷⁾ . Për patatet niveli maksimal i aplikuar vlen për lëkurën e patates	0.10
3.1.11	Perime të familjes brassica, perime me fletë ⁽⁴³⁾ dhe kërpudhat e mëposhtme ⁽²⁷⁾ : <i>Agaricus bisporus</i> (kërpudha të zakonshme), <i>Pleurotus ostreatus</i> (kërpudha Oyster), <i>Lentinula edodes</i> (kërpudha Shiitake)	0.30
3.1.12	Fruta, duke përfshirë manaferrat dhe frutat e vogla ⁽²⁷⁾	0.10
3.1.13	Manaferrat dhe frutat e vogla ⁽²⁷⁾	0.20
3.1.14	Yndyrna dhe vajra, duke përfshirë dhe yndyrën e qumështit	0.10
3.1.15	Lëngje frutash, lëngje frutash të koncentruara të riformuluara dhe nektar frutash ⁽¹⁴⁾	0.050
3.1.16	Verë (duke përfshirë verë të gazuar, me përjashtim të likerit të verës) musht, raki dardhe dhe verë frutash ⁽¹¹⁾	0.20 ⁽²⁸⁾
3.1.17	Verë e aromatizuar, pije me bazë vere të aromatizuar dhe kokteile vere të aromatizuar ⁽¹³⁾	0.20 ⁽²⁸⁾
3.1.18	Suplementet ushqimore ⁽³⁹⁾	3.0
3.2	Kadmiumi	
3.2.1	Mishi (me përjashtim të të përbrendshmeve) i gjedhit, deleve, derrave dhe shpendëve ⁽⁶⁾	0.050
3.2.2	Mish kali, me përjashtim të të brendshmeve ⁽⁶⁾	0.20
3.2.3	Mëlçi e gjedhit, deleve, derrave dhe shpendëve ⁽⁶⁾	0.50
3.2.4	Veshkë e gjedhit, deleve, derrave dhe shpendëve ⁽⁶⁾	1.0
3.2.5	Muskuli i peshkut ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ , duke përfshirë speciet e listuara në 3.2.6, 3.2.7 dhe 3.2.8.	0,050
3.2.6	Muskuli i mishit të peshqve të mëposhtëm ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ : <i>Bonito</i> (<i>Sarda sarda</i>) <i>Krap deti me dy shiritë</i> (<i>Diplodus vulgaris</i>) <i>Ngjala</i> (<i>Anguilla anguilla</i>) <i>Qefull i hirtë</i> (<i>Mugil labrosus labrosus</i>) <i>Kal skumbri</i> (<i>Trachurus species</i>) <i>Peshkë tropikal</i> (<i>Lutjanus imperialis</i>) <i>Skumbri</i> (<i>Scomber species</i>) <i>Sardele</i> (<i>Sardina pilchardus</i>) <i>Sardele</i> (<i>Sardinops species</i>) <i>Ton</i> (<i>Thunnus species</i> , <i>Euthynnus species</i> , <i>Katsuwonus pelamis</i>) <i>Shojzë deti</i> (<i>Dicologlossa cuneata</i>)	0,10
3.2.7	Muskuli i mishit të peshkut ton (speciet Auxis) ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ ;	0.20
3.2.8	Muskuli i mishit të peshqve të mëposhtëm ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ : Sardele (speciet <i>Engraulis</i>) Peshku shpatë (<i>Xiphias gladius</i>)	0,30
3.2.9	Krustaceve ⁽²⁶⁾ : mishi i muskujve që ka divergjuar nga trangu aksial dhe stomaku ⁽⁴⁴⁾ . Në rastin e gaforreve dhe gaforreve të ngjashme me krustacet (<i>Brachyura</i> dhe <i>Anomura</i>) mishi i muskujve që ka divergjuar nga trangu aksial	0.50
3.2.10	Molusqet bivalve ⁽²⁶⁾	1,0
3.2.11	<i>Cephalopode</i> (pa organet e brendshme) ⁽²⁶⁾	1.0
3.2.12	Drithëra, duke përfshirë krundet, embrionin, grurin dhe orizin	0.10
3.2.13	Krundet, embrionin, grurin dhe orizin	0.20
3.2.14	Soja	0.20
3.2.15	Perimet dhe frutat, duke përfshirë perimet me fletë, erëzat e freskëta, kërpudhat, perimet kërcellore, perimet rrënjore dhe me zhardhok ⁽²⁷⁾	0.050
3.2.16	Perimet kërcellore, perimet rrënjore dhe me zhardhok, duke përfshirë selinon ⁽²⁷⁾ . Për patatet niveli maksimal vlen për lëkurën e patates	0.10
3.2.17	Perimet me gjethe, erëzat e freskëta, çdo bimë me gjethe e klasës <i>brassica</i> , selino dhe kërpudhat, e mëposhtme ⁽²⁷⁾ : <i>Agaricus bisporus</i> (kërpudha të zakonshme), <i>Pleurotus ostreatus</i> (kërpudha Oyster), <i>Lentinula edodes</i> (kërpudha Shiitake)	0.20
3.2.18	Kërpudhat, duke përfshirë ato të listuara në pikën 3.2.17 ⁽²⁷⁾	1.0
3.2.19	Suplementet ushqimore ⁽³⁹⁾ që konsistojnë ekskluzivisht ose kryesisht në alga deti të thara, produktet që rrjedhin nga algat e detit ose molusqe bivalve të thara	1.0
3.2.20	Suplementet ushqimore ⁽³⁹⁾ , të përbëra vetëm ose kryesisht nga alga deti të thata apo produkteve që rrjedhin nga algat e detit	3.0
3.3	Merkuri	



3.3.1	Produktet e peshkut ⁽²⁶⁾ dhe muskuli i mishit të peshkut ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ , duke përjashtuar speciet e listuara në 3.3.2. Niveli maksimal për krustacet aplikohet për mishin e muskujve që ka diverguar nga trugu aksial dhe stomaku ⁽⁴⁴⁾ . Në rastin e gaforreve dhe gaforreve të ngjashme me krustacet (<i>Brachyura</i> dhe <i>Anomura</i>) mishi i muskujve që ka diverguar nga trugu aksial	0,50
3.3.2	Muskuli i mishit të peshkut të mëposhtëm ⁽²⁴⁾ ⁽²⁵⁾ : <i>Lophius species</i> <i>Anarhichas lupus</i> <i>Sarda sarda</i> <i>Anguilla species</i> <i>Hoplostethus species</i> <i>Coryphaenoides rupestris</i> <i>Hippoglossus hippoglossus</i> <i>Makaira species</i> <i>Lepidorhombus species</i> <i>Mullus species</i> <i>Esox lucius</i> <i>Orcynopsis unicolor</i> <i>Tricopterus minutus</i> <i>Centroscymnus coelolepis</i> <i>Raja species</i> <i>Sebastes marinus</i> , <i>S. mentella</i> , <i>S. viviparus</i> <i>Istiophorus platypterus</i> <i>Lepidopus caudatus</i> , <i>Aphanopus carbo</i> <i>Pagellus species</i> <i>Peshkagenët (të gjitha speciet)</i> <i>Lepidocybium flavobrunneum</i> , <i>Ruvettus pretiosus</i> , <i>Gempylus serpens</i> <i>Acipenser species</i> <i>Xiphias gladius</i> <i>Thunnus species</i> , <i>Euthynnus species</i> , <i>Katsuwonus pelamos</i>	1,0
3.3.3	Suplementet ushqimore ⁽³⁹⁾	0.10
3.4	Kallaj (inorganik)	
3.4.1	Ushqime të konservuara të tjera nga pijet	200
3.4.2	Pije të konservuara, duke përfshirë lëngun e frutave dhe perimeve	100
3.4.3	Ushqime për bebe të konservuara dhe ushqimet e përpunuara me bazë në drithëra për foshnjat dhe fëmijë të vegjël, me përjashtim të produkteve të thara dhe pluhur ⁽³⁾ ⁽²⁹⁾	50
3.4.4	Formula për foshnja të konservuara dhe <i>follow up</i> formula (duke përfshirë qumështin për foshnja dhe qumështin <i>follow up</i>), duke përjashtuar produktet e thara dhe pluhur ⁽⁸⁾ ⁽²⁹⁾	50
3.4.5	Ushqime dietike të konservuara për qëllime të veçanta mjekësore ⁽⁹⁾ ⁽²⁹⁾ të përcaktuara posaçërisht për foshnjat, me përjashtim të produkteve të thara dhe pluhur	50

Pjesa 4: 3-monokloropropan-1,2-diol (3-MCPD)

Produktet ushqimore (1)		Nivelet max. (µg/kg)
4.1	Proteina vegetale të hidrolizuara ⁽³⁰⁾	20
4.2	Salcë soje ⁽³⁰⁾	20

Pjesa 5: Dioksinat dhe PCBs⁽³¹⁾

Produkte ushqimore		Nivelet maksimale		
		Shuma e dioksinave (WHO-PCDD/F-TEQ) ⁽³²⁾	Shuma e dioksinave dhe e dioksinës-të ngjashme PCBs (WHO-PCDD/F-PCB-TEQ) ⁽³²⁾	Shuma e PCB28, PCB52, PCB101, PCB138, PCB153 dhe PCB180 (ICES-6) ⁽³²⁾
5.1	Mishi dhe produktet e mishit (duke	2.5 pg/gr	4.0 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	40 ng/gr



	përrjashtuar të brendshmet e ngrënshe) të kafshëve të mëposhtme ⁽⁶⁾ : - gjedh dhe dhen; - shpendë; - derra	dhjam ⁽³³⁾ 1.75 pg/gr dhjam ⁽³³⁾ 1.0 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	3.0 pg/gr dhjam ⁽³³⁾ 1.25 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	dhjam ⁽³³⁾ 40 ng/gr dhjam ⁽³³⁾ 40 ng/gr dhjam ⁽³³⁾
5.2	Mëlçia e kafshëve tokësore të përmendura në 5.1 ⁽⁶⁾ , dhe produkte që rrjedhin prej tyre	4.5 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	10.0 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	40 ng/gr dhjam ⁽³³⁾
5.3	Muskuli i mishit të peshkut dhe produktet e tyre ⁽²⁵⁾ ⁽³⁴⁾ , me përjashtim të: - ngjalë e egër e kapur; - peshk i egër i ujërave të freskëta i kapur, me përjashtim të specieve të peshkut diadromous i kapur në ujëra të freskëta. Niveli maksimal për krustacet aplikohet për mishin e muskujve që ka diverguar nga trangu aksial dhe stomaku ⁽⁴⁴⁾ . Në rastin e gaforreve dhe gaforreve të ngjashme me krustacet (<i>Brachyura</i> dhe <i>Anomura</i>) mishi i muskujve që ka diverguar nga trangu aksial.	3,5 pg/g peshë e lagur	6,5 pg/g peshë e lagur	75 ng/g peshë e lagur
5.4	Muskuli i mishit të peshkut të egër të ujërave të freskëta i kapur, me përjashtim të specieve të peshkut diadromous i kapur në ujëra të freskëta	3,5 pg/g peshë e lagur	6.5 pg/g peshë e lagur	125 ng/g peshë e lagur
5.5	Muskuli i mishit të ngjalës së egër të kapur (<i>Anguilla anguilla</i>) dhe produktet e saj	3,5 pg/g peshë e lagur	10,0 pg/g peshë e lagur	300 ng/g peshë e lagur
5.6	Mëlçia e peshkut dhe produktet e përftuara prej tij me përjashtim të vajit të detit referuar në pikën 5.7	–	20,0 pg/g peshë e lagur	200 ng/g peshë e lagur
5.7	Vajra detare (vaj nga trupi i peshkut, vaj i mëlçisë peshkut dhe vajrat e organizmave të tjerë detarë të destinuar për konsum njerëzor)	1.75 pg/gr dhjam	6.0 pg/gr dhjam	200 ng/gr dhjam
5.8	Qumësht i papërpunuar ⁽⁶⁾ dhe prodhime qumështi ⁽⁶⁾ , duke përfshirë dhe yndyrën e qumështit	2.5 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	5.5 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	40 ng/gr dhjam
5.9	Vezë pule dhe produkte vezësh ⁽⁶⁾	2.5 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	5.0 pg/gr dhjam ⁽³³⁾	40 ng/gr dhjam
5.10	Dhjamë nga kafshët e mëposhtme: - gjedh dhe dhen; - shpendë; - derra	2.5 pg/gr dhjam 1.75 pg/gr dhjam 1.0 pg/gr dhjam	4.0 pg/gr dhjam 4.0 pg/gr dhjam 1.5 pg/gr dhjam	40 ng/gr dhjam 40 ng/gr dhjam 40 ng/gr dhjam
5.11	Dhjamë nga kafshë të ndryshme	1.5 pg/gr dhjam	2.50 pg/gr dhjam	40 ng/gr dhjam
5.12	Vajra dhe yndyrna vegjetale	0.75 pg/gr dhjam	1.25 pg/gr dhjam	40 ng/gr dhjam
5.13	Ushqime për bebe dhe fëmijë të rritur	0.1 pg/g peshë e lagur	0.2 pg/g peshë e lagur)	1.0 ng/gr peshë e lagur

Pjesa 6: Hidrokarburet aromatike policiklike

Produktet ushqimore		Nivelet maksimale (µg/kg)	
6.1	Benzo(a)pireni, benz(a)anthracene, benzo(b)fluoranthene dhe krisene	Benzo(a)pireni	Shuma e Benzo(a)pireni, benz(a)anthracene, benzo(b)fluoranthene dhe krisene ⁽⁴⁵⁾
6.1.1	Vajrat dhe yndyrat (duke përrjashtuar gjalpin e kakaos dhe vajin e kokosit) të përcaktuara për konsum të drejtpërdrejtë njerëzor ose përdorim si përbërës në ushqime.	2.0	10.0



6.1.2	Kakao kokërr dhe produktet që rrjedhin prej tij	5.0 µg/kg yndyrë	30.0 µg/kg yndyrë
6.1.3	Vaj i arrës së kokosit i përcaktuar për konsum direkt human ose i përdorur si përbërës ushqimor.	2.0	20.0
6.1.4	Mishra të tymosura dhe produkte mishrash të tymosur.	2.0	12.0
6.1.5	Mish i muskulit të peshkut të tymosur dhe i produkteve të peshkut të tymosur ⁽²⁵⁾ ⁽³⁶⁾ , duke përfshirë produktet e peshkut të listuara në pikat 6.1.6 dhe 6.1.7. Niveli maksimal për krustacet aplikohet për mishin e muskujve që ka diverguar nga trangu aksial dhe stomaku ⁽⁴⁴⁾ . Në rastin e gaforreve dhe gaforreve të ngjashme me krustacet (<i>Brachyura</i> dhe <i>Anomura</i>) mishi i muskujve që ka diverguar nga trangu aksial.	2.0	12.0
6.1.6	Peshk i imët i tymosur dhe peshk i imët i tymosur i konservuar ⁽²⁵⁾ ⁽⁴⁷⁾ (<i>sprattus sprattus</i>); molusqet bivalve (të freskëta, të ftohta ose të ngrira) ⁽²⁶⁾ ; mish i trajtuar në të nxehtë dhe produkte mishi të trajtuara në të nxehtë ⁽⁴⁶⁾ shitur për konsumatorin e fundit	5.0	30.0
6.1.7	Molusqet bivalve ⁽³⁶⁾ (i tymosur)	6.0	35.0
6.1.8	Ushqimet e përpunuara me bazë drithërash dhe ushqime për foshnje dhe fëmijë të vegjël ⁽³⁾ ⁽²⁹⁾	1.0	1.0
6.1.9	Formula për fëmijë dhe <i>follow up</i> formulat, duke përfshirë edhe qumështin për foshnje dhe qumështin <i>follow up</i> ⁽⁸⁾ ⁽²⁹⁾	1.0	1.0
6.1.10	Ushqimet dietetike për qëllime të veçanta mjekësore ⁽⁹⁾ ⁽²⁹⁾ të paracaktuara në mënyrë të veçantë për foshnjat		

Pjesa 7: Melamina dhe strukturat analoge të saj

Produktet ushqimore		Nivelet maksimale (µg/kg)
7.1	Melaminë	
7.1.1	Ushqime me përjashtim të formula e për bebe dhe <i>follow-on</i> formula e ⁽⁴⁸⁾	2.5
7.1.2	Formula e për bebe dhe <i>follow-on</i> formula e të bëra pluhur	1

Shënime:

⁽¹⁾ Për sa u përket fruta, perimeve dhe drithërave, referimi është bërë për produktet ushqimore të listuara në kategoritë përkatëse, siç është përcaktuar në urdhër nr. 313, datë 26.6.2006, “Për miratimin e rregullores “Për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore dhe ushqimet me origjinë bimore”. *Fagopyrum sp.* është përfshirë në “drithërat” dhe produktet e tij janë të përfshira në “produktet e drithërave”. Pemët arnore nuk mbulohen nga niveli maksimal për fruta.

⁽²⁾ Nivelet maksimale nuk aplikohen për spinaqin e freskëta që është objekt i përpunimit dhe i cili është transportuar direkt nga fusha në stabilimentin e përpunimit.

⁽³⁾ Produkte ushqimore të listuara në këtë kategori sipas urdhrit nr. 616, datë 27.12.2006, “Për ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për fëmijët foshnja dhe fëmijë më të rritur”.

⁽⁴⁾ Niveli maksimal u referohet produkteve të gatshme për përdorim (të tregtuara si të tilla ose pas

përpunimit në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi).

⁽⁵⁾ Nivelet maksimale i referohen pjesës ushqimore të pemëve të kikirikëve dhe të arrave. Nëse *groundnuts* (kikirikë) dhe drurët arrorë “në guaskë” janë analizuar, ajo është marrë kur llogaritet që përmbajtja e aflatoksinës jep gjithë ndotjen në pjesën e ngrënshme, përveç në rastin e arrave të Brazilit.

⁽⁶⁾ Ushqimore e përcaktuara në këtë kategori sipas paketës higjienike që përcakton rregullat specifike të higjienës për ushqimin me origjinë shtazore.

⁽⁷⁾ Niveli maksimal i referohet lëndës së thatë.

⁽⁸⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori sipas urdhrit nr. 456, datë 17.12.2007, “Mbi miratimin e rregullores “Për formulat ushqimore për foshnja dhe formulat rrjedhëse”.

⁽⁹⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori sipas përcaktimit të ushqimeve dietike për qëllime të veçanta mjekësore.

⁽¹⁰⁾ Niveli maksimal i referohet rastit të



qumështit dhe të produkteve të qumështit, për produkte të gatshme për përdorim (që tregtohet si të tilla ose ripërpunohen, sipas udhëzimit të prodhuesit) dhe në rastin e produkteve të tjera përveç atyre të qumështit dhe produkteve të tij, për lëndën e thatë. Lënda e thatë përcaktohet në përputhje me udhëzimin nr. 12, datë 29.9.2010, “Mbi metodat e marrjes së mostrave dhe analizave për kontrollin zyrtar të nivelit të mykotoksinave në ushqime”.

⁽¹¹⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori janë sipas organizimit të tregut të përbashkët të verës, i ndryshuar.

⁽¹²⁾ Niveli maksimal zbatohet për produktet e prodhuara nga korrija e 2005-s e tutje.

⁽¹³⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori sipas urdhrit nr. 392, datë 29.2.2009, “Për miratimin e rregullores “Mbi përkufizimin, përshkrimin, dhe paraqitjen e verërave të aromatizuara, pijeve me bazë vere të aromatizuara dhe produkte kokteile të verërave të aromatizuara”. Niveli maksimal për OTA të zbatueshme për këto pije është funksion i përqindjes së verës dhe/apo të rrushit të pranishëm në produktin e përfunduar.

⁽¹⁴⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori janë sipas urdhrit nr. 444, datë 7.12.2007, “Mbi miratimin e rregullores “Mbi lëngjet e frutave dhe produktet e ngjashme me to””\.

⁽¹⁵⁾ Produktet ushqimore të listuara në këtë kategori sipas urdhrit nr. 223, datë 8.7.2009, “Për miratimin e rregullores “Mbi rregullat e përgjithshme, për përcaktimin, përshkrimin dhe prezantimin e pijeve alkoolike”.

⁽¹⁶⁾ Foshnjat dhe fëmijët e vegjël, siç përcaktohet në urdhrin nr. 616, datë 27.12.2006, “Për ushqimet e përpunuara me bazë drithërat dhe ushqimet për fëmijët foshnja dhe fëmijë më të rritur”.

⁽¹⁷⁾ Për qëllim të zbatimit të niveleve maksimale për *deoxynivalenol*, *zearalenone*, T-2 dhe HT-2 toksina të dhëna në pikat 2,4, 2,5 dhe 2,7 orizi nuk është përfshirë në “drithërat” dhe produktet e orizit nuk janë të përfshira në “produktet e drithërave”.

⁽¹⁸⁾ Niveli maksimal vlen për drithëra të papërpunuara të vendosura në treg për fazën e parë të përpunimit. “Faze e parë e përpunimit” do të thotë çdo trajtim fizik ose termike, përveç tharjes, për drithin. Procedurat e pastrimit, klasifikimit dhe tharjes nuk konsiderohet të jenë “Faza e parë e përpunimit” asnjë veprim fizik nuk ushtrohet mbi

vetë kokrrën dhe kokrra mbetet e paprekur pas pastrimit dhe klasifikimit. Në prodhimin e integruar dhe të sistemeve të përpunimit, niveli maksimal vlen për drithëra të papërpunuara në rast ato janë të destinuara për fazën e parë të përpunimit.

⁽¹⁹⁾ Niveli maksimal vlen për drithërat e korrur që nga viti 2005/06, në përputhje me procedurat e marrjes së drithërave nga ndërhyrja e agjencive dhe metodat e analizave për përcaktimin e cilësisë së drithërave.

⁽²⁰⁾ Niveli maksimal është aplikuar nga 1 tetori 2007.

⁽²²⁾ Makarona (e thatë) do të thotë makarona me një përmbajtje të ujit prej rreth 12%.

⁽²³⁾ Niveli maksimal është aplikuar nga 1 tetori 2007.

⁽²⁴⁾ Peshqit e listuar në këtë kategori të përcaktuar në kategorinë (a), me përjashtim të mëlçisë së peshkut me kod CN 0302 70 00.

⁽²⁵⁾ Kur peshqit janë për t'u ngrënë të tërë, niveli maksimal duhet të zbatohet në të tërë peshkun.

⁽²⁶⁾ Produktet ushqimore ndodhen brenda kategorisë (c) dhe (f) të listës.

⁽²⁷⁾ Niveli maksimal zbatohet pas larjes së frutave dhe perimeve dhe ndarjes së pjesës ushqimore.

⁽²⁸⁾ Niveli maksimal zbatohet për produktet e prodhuara nga mbledhja e frutave nga 2001-shi e tutje.

⁽²⁹⁾ Niveli maksimal i referohet produktit të shitur.

⁽³⁰⁾ Niveli maksimal është dhënë për produktin e lëngshëm që përmban 40% lëndë të thatë, që i korrespondon një niveli maksimal prej 50 µg / kg në lëndë të thatë. Niveli duhet të jetë rregulluar në mënyrë proporcionale sipas përmbajtjes së lëndës së thatë të produkteve.

⁽³¹⁾ Dioksinat (shuma e dibenzo-para-dioxins të poliklorinuara (PCDD) dhe dibenzofurane të poliklorinuara (PCDF).



<i>Të ngjashëm</i>	<i>Vlera TEF</i>	<i>Të ngjashëm</i>	<i>Vlera TEF</i>
Dibenzo-p-dioxins ('PCDDs')		'Dioxin-like' PCBs Non-ortho PCBs+ Mono-ortho PCBs	
2,3,7,8-TCDD	1		
1,2,3,7,8-PeCDD	1	<i>Non-ortho PCBs</i>	
1,2,3,4,7,8-HxCDD	0,1	PCB 77	0,0001
1,2,3,6,7,8-HxCDD	0,1	PCB 81	0,0003
1,2,3,7,8,9-HxCDD	0,1	PCB 126	0,1
1,2,3,4,6,7,8-HpCDD	0,01	PCB 169	0,03
OCDD	0,0003		
Dibenzofurans ('PCDFs')		<i>Mono-ortho PCBs</i>	
2,3,7,8-TCDF	0,1	PCB 105	0,00003
1,2,3,7,8-PeCDF	0,03	PCB 114	0,00003
2,3,4,7,8-PeCDF	0,3	PCB 118	0,00003
1,2,3,4,7,8-HxCDF	0,1	PCB 123	0,00003
1,2,3,6,7,8-HxCDF	0,1	PCB 156	0,00003
1,2,3,7,8,9-HxCDF	0,1	PCB 157	0,00003
2,3,4,6,7,8-HxCDF	0,1	PCB 167	0,00003
1,2,3,4,6,7,8-HpCDF	0,01	PCB 189	0,00003
1,2,3,4,7,8,9-HpCDF	0,01		
OCDF	0,0003		

Shkurtime e përdorura: T=tetra; Pe=penta; He=hekza; Hp=hepta' O=okta; CDD=klordibenzodioksine; CDF=klordibenzofuran; CB=klorbifenil

⁽³²⁾ Përqendrimet e kufirit të sipërm: përqendrimet e kufirit të sipërm janë llogaritur duke supozuar se të gjitha vlerat e ndryshme të të ngjashmëve nën kufirin sasior janë të barabarta me kufirin sasior.

⁽³³⁾ Niveli maksimal i shprehur në yndyrë nuk është i zbatueshëm për ushqimet që përmbajnë <2% yndyrë. Për ushqimet që përmbajnë më pak se 2% yndyrë, niveli maksimal i aplikueshëm është niveli në produktet bazë që korrespondon me nivelin në produktin bazë për ushqimet që përmbajnë 2% yndyrë, e llogaritur nga niveli maksimal i përcaktuar në bazë yndyre, duke përdorur formulën e mëposhtme:

Niveli maksimal i shprehur në produktin

bazë për ushqimet që përmbajnë më pak se 2% yndyrë = niveli maksimal i shprehur në yndyrë për këtë ushqim x 0,02.

⁽³⁴⁾ Artikujt ushqimorë të listuar në këtë kategori përcaktohen në kategoritë (a), (b), (c), (e) dhe (f) të listës, me përjashtim të mëlçisë së peshkut referuar në pikën 5.11.

⁽³⁶⁾ Artikujt ushqimorë të listuar në këtë kategori përcaktohen në kategoritë (b), (c) dhe (f) të listës.

⁽³⁷⁾ Përjashtimi aplikohet vetëm për misrin për të cilin ai është i qartë, p.sh., nëpërmjet etiketimit, destinacionit, kur ai është përcaktuar për përdorim në një proces vetëm për bluarje të lagur (prodhim amidoni).



⁽³⁸⁾ Në rastin e mëlçisë së peshkut të konservuar, niveli maksimal aplikohet për përmbajtjen e ngrënshme të konservuar.

⁽³⁹⁾ Niveli maksimal vlen edhe për shtesat ushqimore të shitura si të tilla.

⁽⁴⁰⁾ Farat vajore janë nën kodet CN 1201, 1202, 1203, 1204, 1205, 1206, 1207 dhe produktet e derivuara CN 1208; pjeprë është nën kodin ex 1207 99.

⁽⁴¹⁾ Në rastin e produkteve që derivojnë/përpunohen prej tyre ane vetëm të derivuara/përpunuara ose pothuajse vetëm nga pemët e arrës përkatëse, nivelet maksimale të përcaktuara për pemët e arrës zbatohen edhe për produktet që derivojnë/përpunohen.

⁽⁴²⁾ Niveli maksimal aplikohet për ekstraktin e pastër dhe të paholluar, 1 kg ekstrakt është përftuar nga 3 ose 4 kg rrënjë.

⁽⁴³⁾ Niveli maksimal për perimet me gjethe nuk aplikohet për erëzat e freskëta (që janë nën kodin numër 02560000 të urdhrit nr. 313, datë 26.6.2006, “Për miratimin e rregullores “Për nivelet maksimale të mbetjeve të pesticideve në produktet ushqimore dhe ushqimet me origjinë bimore”.

⁽⁴⁴⁾ Ky përkufizim përjashton cefalotoraksin e krustaceve.

⁽⁴⁵⁾ Përqendrimet e lidhjes më të ulët janë llogaritur duke supozuar se të gjitha vlerat e katër substancave në përcaktimin sasior janë zero.

⁽⁴⁶⁾ Mishi dhe produktet e mishit që kanë pësuar një trajtim me ngrohje potencialisht rezultojnë në formimin e PAH, p.sh., vetëm në tiganisje dhe pjekje.

⁽⁴⁷⁾ Për produktin konservuar analiza duhet të kryhet në të gjithë përmbajtjen e konservës. Për sa i përket nivelit maksimal nenet 2 (1) (c) dhe 2 (2) do të zbatohen për të gjithë produktin e përbërë.

⁽⁴⁸⁾ Niveli maksimal nuk zbatohet për ushqime për të cilat është provuar se niveli i melaminës më i lartë se 2,5 mg/kg është pasojë e përdorimit të autorizuar të ciromazinës si insekticid. Niveli i melaminës nuk duhet të tejkalojë nivelin e ciromazinës.

URDHËR

Nr. 1, datë 11.1.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 961, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, neni 6, pikat 10, 11 dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. ___, datë 11.1.2016, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë me popullsinë më të madhe, Kryetari i Bordit të Partnerëve për Zhvillim

URDHËRON:

Emërimin e z. Shpëtim Quku, si Drejtor i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal nr. 1.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Voltana Ademi

URDHËR

Nr. 1, datë 11.1.2016

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 961, datë 2.12.2015, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal”, neni 6, pikat 10, 11 dhe të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. ___, datë 11.1.2016, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë me popullsinë më të madhe, Kryetari i Bordit të Partnerëve për Zhvillim

URDHËRON:

Emërimin e z. Litian Broka, si Drejtor i Agjencisë për Zhvillimin Rajonal nr. 3.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sotirag Filo

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë